# DËSHMI ARKIVI

**A-453287**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shporta bëhet gjithnjë e më e shtrenjtë, qytetarët: Marrim më të lirat, mishin e kemi rrallë \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/17/shporta-behet-gjithnje-e-me-e-shtrenjte-qytetaret-marrim-me-te-lirat-mishin-e-kemi-rralle/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 19:01:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 18:57:59 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d445b37f53117c5d6a27403516b060730f8160a0bc929e9710c344c349a717b0` |
| TEKSTI | `66ab03f2e6d83244e2e2ab836fbd3960d37e4e7a35e227dccb11ecc524fe0ede` |
| PAMJA | `837536c78da5c8b9e93935d74b9a10b2ec578ecee8d00c786e2344498aaf9806` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6c5922db5a9a14b752fded11388a5df5f7d2b6283393c4bcc2ce56bb2878d8d5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `902d0413a229cd6f0d4d0cd18f47f680be9b1c51dede64b7e44b0e89ca82109d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6c5922db5a9a14b752fded11388a5df5f7d2b6283393c4bcc2ce56bb2878d8d5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Shporta bëhet gjithnjë e më e shtrenjtë, qytetarët: Marrim më të lirat, mishin e kemi rrallë

20:57 : 17/09/2026 në **AKTUALITET, SOCIALE**



Çmimet e larta të produkteve të shportës po ulin konsumin e qytetarëve. Edhe pse janë ushqime të domosdoshme, qytetarët thonë se po blejnë më pak, madje po shmangin blerjet e frutave ose perimeve që kushtojnë shumë.

"Janë shumë të shtrenjta. Nuk përballohen. Papunësi e madhe, edhe me zor të madh. Sa të vështirë e ka pensionisti apo mosha e tretë t'i përballojë të gjitha? Shumë. Shumë e vështirë është. Nuk përballohen. Me ilaçe, me të gjitha… A keni ndihmën e fëmijëve? Unë gocën e kam pa punë. Ka mbaruar shkollën e lartë, në arsim, është pa punë. Çuni ishte në punë, po atij s'i del për vete me ato rroga të ulëta", thotë një pensionite.

Kostoja e jetesës, sipas qytetarëve, rëndon më së shumti mbi pensionistët. Shumë prej tyre thonë se një pjesë e konsiderueshme e pensionit shkon vetëm për ilaçe, duke lënë gjithnjë e më pak hapësirë për ushqimet bazë.

"Më vështirë s'ka ku të shkojë. Pse ndodh kjo? Kush janë më të shtrenjtat? Të gjitha! Gjithë shporta komplet e shtrenjtë është. Këtej ilaçet, të gjitha. A mundet një pensionist t'i përballojë çdo gjë me pensionin që ka? Po mos të na ndihmojnë kalamajtë, kemi mbaruar. Jemi shkatërruar. Vetëm ilaçet, 36 mijë lekë janë", shprehet një tjetër.

Rritja e çmimeve nuk kufizohet vetëm te produktet e shportës. Edhe buka, një nga produktet më bazë të tryezës, sipas qytetarëve, është bërë më e shtrenjtë, duke e rënduar edhe më tej buxhetin familjar.

**Lexo edhe:**

Nafta drejt 230 lekë për litër, qeveria rri duarkryq

Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta ?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë

Përveç çmimeve, qytetarët ngrenë shqetësime edhe për cilësinë e ushqimeve, duke përmendur rastet e produkteve të refuzuara jashtë vendit për shkak të pesticideve. Sipas tyre, kufizimi i konsumit nuk lidhet vetëm me pamundësinë ekonomike, por edhe me pasigurinë për atë që përfundon në tryezë.

**TË GJITHA**


Shporta bëhet gjithnjë e më e shtrenjtë, qytetarët: Marrim më të lirat, mishin e kemi rrallë
20:57 : 17/09/2026


Mbyllen fjalimet te Kryeministria, protestuesit marshojnë në rrugët e Tiranës
20:47 : 17/09/2026


Policia hyn me forcë në shtëpinë e futbollistit në Rumani dhe e dërgojnë në psikiatri
20:36 : 17/09/2026


Bardhi: Kompania që u kap me 41 kg kokainë, përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD
20:26 : 17/09/2026


Çoi padashje një video në grupin e shoqeve, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares në Tiranë
20:11 : 17/09/2026


Moti i ftohtë mund të paralajmërojë rritjen e rasteve të arrestit kardiak
20:03 : 17/09/2026


Goditet grupi i drogës në Spanjë/ 15 të arrestuar, mes tyre edhe shqiptarë
19:59 : 17/09/2026

"Me këto të ardhura jo, me këto pensione. Çfarë t'i përballosh? Do kapësh më të thjeshtat. E këto ndikojnë keq te kequshqyerja, te shumë gjëra, siç po bëjnë tani me helmet, pesticidet. Mishi është shumë i rrallë, nuk e kapin dot. Tani venë ata sa për të nxjerrë merakun, marrin një qofte, se kushedi çfarë përbërje ka", thotë një qytetar.

Mes çmimeve që vijojnë të rriten dhe pensioneve që, sipas qytetarëve, nuk mbulojnë më nevojat bazë, shporta e konsumit po tkurret dita-ditës. Për shumë familje, zgjedhja mes ushqimit dhe ilaçeve është kthyer në një realitet të përditshëm./Euronews

**Etiketa:** cmime pensionista shporta shporta e konsumit


## Lajme të lidhura




**Nafta drejt 230 lekë për litër, qeveria rri duarkryq**
16:31 : 14/09/2026



**Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta ?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë**
08:09 : 13/09/2026



**Çmimi i lartë i karburanteve, qeveria italiane zgjat afatin për uljen e akcizës së naftës**
18:18 : 10/09/2026



**Peshku shtrenjtohet me 9.8%, perimet me 8%, si ndryshuan çmimet e ushqimeve në gusht**
19:34 : 08/09/2026



**Nafta dhe ushqimet më lirë në Greqi, radhë të gjata në Kapshticë**
18:19 : 06/09/2026



**Greqia ndërhyn te çmimet, mbi 1,600 produkte me ulje në supermarkete**
11:31 : 31/08/2026



BOLD NEWS

**RRETH NESH**

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

**NA NDIQ**

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.